



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 900/3 Prot.

Tiranë, më 21/7/2017

REKOMANDIM

Nr. 31, datë 21/7 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Credins Bank", Tiranë:

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 158, datë 12.06.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Credins Bank", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

1. Kontrolluesi "Credins Bank" ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "punëmarrës" (punonjës), manualisht dhe në format elektronik, në rrjetin e brendshëm kompjuterik, për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numër llogarie, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave cctv, foto, tinguj, adresa, të dhëna për shëndetin, dëshmi penalteti.

2. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve, ka instaluar një sistem kamerash CCTV në degët ku ushtron veprimtarinë si dhe në ambientet e brendshme të zyrave qendrore. Disa prej kamerave në zyrën qendrore të vendosura në katin e dytë, të tretë dhe të katërt janë pozicionuar dhe marrin imazhe në ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes së ambienteve. Kamerat mbikëqyrin pothuajse të gjithë punonjësit që punojnë në këto ambiente.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit CCTV në ambientet e punës, në kuadër të impaktit që ka mbi veprimtarinë e punonjësve, pasojat që sjell ndaj tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së tyre.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 19.07.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në parashtrimet e paraqitura (shkresa nr. 36355/1 prot. datë 19.07.2017) gjatë seancës dëgjimore të mbajtur në ambientet e Zyrës së Komisionerit, përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimin se përdorimi i sistemit CCTV në disa ambiente të punës (në zyrat qendrore e bankës) është për arsytet:

- *"Për mbrojtjen e të dhënave që përpunohen si pjesë e aktivitetit bankar, për të parandaluar keqpërdorimin apo dëmtimin e qëllimshëm të dokumentacionit bankar".*

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e punës së punonjësve (zyrat qendrore) çënon privatësinë e punonjësve dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar), pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (parandalimin e keqpërdorimit/dëmtimit të qëllimshëm të dokumentacionit bankar), referuar Udhëzimit nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka shprehur gadishmërinë për marrjen e masave për rekuperimin e shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, përmes ripozicionimit ose zhvendosjes së kamerave që çënojnë privatësinë e punonjësve.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "**Credins Bank**", të pezulloj përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga kamerat e pozicionuara në ambientin e punës së punonjësve, në zyrat qendrore të saj në katin e dytë, të tretë dhe të katërt.
2. Kontrolluesi "**Credins Bank**", të ketë në vëmendje përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave të siguruara nëpërmjet sistemit të video survejimit, në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08/09/2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 21/7/2017

